

Republika e Shqipërisë
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Statusi i Vendbanimeve Rome në Shqipëri





Detyrimet ligjore

- Strategjia Kombëtare Ndërmnistrore “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom dhe Egjiptian” financuar nga OSBE në 2003 dhe Plani i Veprimit në 2005
- Rekomandimet e Këshillit të Europës
- Ligji nr. 9232 për strehimin, i ndryshuar në 2012
- Akti Normativ nr. 3/2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”,



Programet sociale te strehimit

- Banesat sociale me qira (Bashkëfinancim 3-palësh Qeveri-NJQV-CEB)
- Banesat me kosto te ulët (0%, 3% Subvencionohet nga qeveria)
 - Kreditimi i lehtësuar
 - Blerja e banesave me kosto të ulët në ato qytete ku kosto mesatare e blerjes në tregun e lirë është më e ulët se ajo e ndërtimit

Ndihma për programet e strehimit

- Bonusi i strehimit – deri në masën 50 % të qirave minimale të banesave në tregun e lirë;
- Subvencionimi i qirasë – kur qiraja e banesës zë më shumë se 25% të të ardhurave neto të familjes.
- Subvencionimi i interesit të kredisë:
 - 0 % interes, për qiramarrësit në ish pronë private;
 - 3% interes përfituesit nëpërmjet njësive të qeverisjes vendore

Përmirësimet ligjore

- Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Strehimin.

Trajtimi i komunitetit Rom dhe atij Egjiptian si pjesë integrale e kësaj strategjie.

- Ndryshimet në ligjin 9232 për strehimin

Zgjerimi i veprimtarisë duke përfshirë përveç zonave urbane edhe ato rurale.

- Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve vlerësohen në bazë të kushteve të:

- Strehimit;
- Familjare;
- Sociale;
- Gjendjes Ekonomike

- Grantet e vogla


Grantet e vogla

- Përfitojnë vetëm familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian
- Zgjidhje problemeve të përmirësimit të kushteve të banimit
 - Përmirësim i infrastrukturës
 - Riparim i cative dhe banesave
 - Paisje me hidrosanitare
 - Ndërtim i banesave të reja etj.

Lidhur me situatën e strehimit, familjet Rome dhe Egjiptiane mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Familjet që jetojnë në shtëpitë e tyre me kushte optimale strehimi. Familjet rome në gjendje shumë të mirë ekonomike dhe/ose që banojnë në të njëjtat zona me popullsinë jo-rome;
- Familjet që jetojnë në shtëpitë e tyre tashmë të legalizuara me kushte të këqija jetese dhe me nevojë urgjente për përmirësim/riparim të shtëpive të tyre dhe infrastrukture tjetër përkatëse;
- Familjet që jetojnë në barraka ose tenda të ndërtuara në “tokë të pazënë”, afër rrugëve ose në brigjet e lumit, pa leje ndërtimi. Në disa raste barrakat dhe tendat janë ndërtuar në tokë private dhe ata i paguajnë qera pronarëve të tokës. Në të dyja rastet ekziston një rrezik potencial që të dëbohen me dhunë nga vendbanimet e tyre, duke mbetur pa strehë;
- Familjet që jetojnë në lagje të varfra tashmë të legalizuara por pa titull pronësie pasi nuk mund të paguajnë tarifatat përkatëse;
- Familjet që jetojnë në lagje të varfra në ndërtim të përkohshëm;
- Familjet me më shumë se 5 anëtarë familjeje që jetojnë në të njëjtën dhomë; dhe
- Familje të tjera që jetojnë në lagje të varfra të ndara që nuk plotësojnë standardet minimale të kushteve të jetesës.

PARAQITJA E GRAFIKËVE SIPAS GRUPIMEVE



Statistika për familjet Rome dhe Egjiptiane që kanë përfituar strehim

- Banesat sociale me qira
 - Në Elbasan 10 familje Rome nga 96 apartamente
 - Në Fier 3 familje Rome nga 96 apartamente
 - Në Berat :
 - 1 familje Rome e cila është larguar nga banesa për shkak të mos përshtatjes në këto banesa (mënyra e jetesës ndryshe);
 - 20 familje Egjiptiane nga 48 apartamente.
- Kreditimi i lehtësuar – nuk ka të dhëna nga bashkitë se sa familje Rome kanë përfituar strehim



Financimi nga buxheti i shtetit për programin e përmirësimit të kushteve të banimit të komunitetit Rom dhe atij Egjiptian

- Për vitin 2014 janë miratuar në buxhetin e MZHUT 30,000,000 lekë për programin “Grante të Vogla”

Konkluzionet

- Ndonëse përmirësimet ligjore kanë zgjeruar fushën e veprimit dhe përfshirjes së këtyre komuniteteve, gjendja reale është thuajse e njëjtë.
- Arsyet :
Mungesa e regjistrimit pranë njësive vendore ku banojnë;
Pamundësia për të vërtetuar të ardhurat e tyre: nga punësimi (informale) / mungesa e regjistrimit pranë zyrave të ndihmës sociale;
Mënyra e jetesës (tradita e komunitetit dhe predispozicioni për të ndryshuar vendqëndrim)

Detyrat që dalin

- Bashkëpunimi me ministritë e linjës dhe NJQV-të, me qëllim gjetjen e alternative për strehimin e familjeve të cilat janë në kufijtë e përjashtimit social (që nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave);
- Fushata për ndërgjegjësimin e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian nëpërmjet NJQV-ve dhe Shoqatave Rome dhe atyre Egjiptiane.



FALEMINDERIT